



inject
Initiative for
Justice and Equality

INSISTOJ NË TË DREJTAT E MIA!

Ndryshimi i Ligjit për Familjen
-
Pasuria e Përbashkët dhe
Mbajtja Financiare

Dhurata për 8 Mars

Më 8 Mars 2019 unë...

INSISTOJ NË TË DREJTAT E MIA!

INJECT – Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi ju uron të gjitha grave dhe vajzave Ditën Ndërkombëtare të Gruas, duke bërë njëherit thirrje që gratë dhe vajzat të jenë këmbëngulëse për realizimin e të drejtave të tyre. Kosova nuk është bërë vetëm nga burrat. Gratë kanë po aq merita sa burrat në krijimin e këtij shteti dhe po ashtu të drejta të garantuara me ligj, që ndaj tyre nuk do të ketë diskriminim në asnjë sferë të jetës.

INJECT rikujton se është përgjegjësi e institucioneve që t'i implementojnë konventat ndërkombëtare për mosdiskriminimin mbi baza gjinore të qytetarëve dhe është përgjegjësi demokratike e qytetarëve që të kërkojnë llogari nga institucionet kur të drejtat e tyre nuk mbrohen mjaftueshëm.

INJECT i bën thirrje ligjvënësit, gjyqësorit, policisë, Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale dhe të gjitha institucioneve përgjegjëse që të jenë të vetëdijshëm, se pa sigurimin e qasjes së plotë në drejtësi, në trashëgimi, pronë, arsim, politikë dhe vendimmarrje për të gjithë qytetarët pa dallim gjinie, nuk mund të ketë zhvillim shoqëror.

INJECT rikujton se asnjë shtet nuk ka mundur të zhvillohet para se t'i avancojë të drejtat e barabarta për të gjithë dhe se barazia nuk është kërkesë për ta dëmtuar njërin e shpërblyer tjetrin, por që barazia është parakusht për zhvillim ekonomik e prosperitet të gjithëmbarshtëm.

INJECT kërkon nga institucionet e gjyqësorit që praktika gjyqësore diskriminuese ndaj grave në rastet e ndarjes së pasurisë së përbashkët të ndalet menjëherë. Gratë nuk kanë nevojë të dëshmojnë se ju takon gjysma e pasurisë bashkëshortore, sepse kjo ju është garantuar me ligj, në nenin 47 të Ligjit për Familjen të Kosovës. Sipas nenit 47, nenit 54 dhe 55, pasuria e përbashkët ndahet në pjesë të barabarta, nëse nuk mund të dëshmohet nga njëri prej bashkëshortëve se ka poseduar pasuri të veçantë para martesës. Gjysma e pasurisë së përbashkët ju takon grave edhe nëse fare nuk kanë punuar jashtë shtëpisë, por janë përkujdesur për fëmijët dhe mirëmbajtjen e shtëpisë.

INJECT i kujton gjykatave dhe gjyqtarëve se vlerësimi monetar me një ekspert financiar i kontributit të nënave në familje është shkelje e dispozitave ligjore dhe diskriminim i

rëndë ndaj grave. Njëherit ju rikujton gjyqtarëve se thirrja në të drejtën e diskrecionit të gjyqtarit duhet të jetë e bazuar në ligj, sepse asnjë gjyqtar nuk ka të drejtë të merr një vendim sipas vlerësimit personal, porse edhe diskrecioni duhet të thirret në një dispozitë ligjore.

INJECT ju tërheqë vërejtjen gjyqësorit për shkëljen e nenit 305 të Ligjit për Familjen në caktimin e vëllimit të ushqimisë. Sipas këtij neni, vëllimi i ushqimisë bëhet sipas standardit jetësor në martesë, ndërsa gjykatat për caktimin e ushqimisë dhe alimentacionit e marrin për bazë standardin jetësor të Kosovës, gjë që është shkelje e dispozitave ligjore. Gjykatat nuk kanë mandat për ta përcaktuar standardin jetësor të qytetarëve, por duhet të zbatojnë ligjet në përpikmëri.

INJECT kërkon nga gjykatat që ta përmbushin detyrën e tyre të përmbarrimit ndaj personave, të cilët nuk i respektojnë vendimet e gjykatës për alimentacion dhe ushqimi.

INJECT e dënon ashpër çdo vonesë nga ana e gjykatave për t'i trajtuar me prioritet rastet e shkurorëzimeve, ku pa pasur të përfshirë dhunë në familje. Vonesat e gjyqësorit për t'i trajtuar rastet kanë për pasojë që pasuria e përbashkët tjetërsohet gjatë vonesës së gjykatave për t'i trajtuar rastet. Kjo edhe më shumë e dëmton qytetarin në pronën e tij dhe atë për shkak të vonesave të gjyqësorit.

INJECT kërkon nga gjyqësori që ta marrin seriozisht obligimin e tyre që sipas detyrës zyrtare të kërkojnë të gjitha provat për gjendjen financiare të bashkëshortëve gjatë caktimit të mbajtjes financiare dhe ndarjes së pasurisë.


PABARAZIA NË SHIFRA - FAKTET E FORTA

	Gra në %	Burra në %
Popullsia sipas gjinive		
<i>Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 14</i>		
	51,00	49,00
Studentët në bachelor dhe master në institucionet arsimore		
<i>Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 32.</i>		
Studime universitare	53,7	46,3
Mësimdhënësit në arsim sipas gjinive		
<i>Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 32.</i>		
Parashkollor	99,70	0,30
Fillor dhe i mesëm i ulët	56,10	43,90
I mesëm I lartë	40,60	59,40
Universitar	33,50	66,50
Pozitat si zyrtarë ose menaxherë të lartë		
Ligjvënës,zyrtar/menagjerë të lartë	15.40	84,60

Përkundër faktit së gratë përbëjnë 51% të popullatës, ato janë grupi më i madh i marginalizuar dhe i shtypur në Kosovë. Kjo bëhet e qartë gjatë analizës së shifrave të paraqitura në këto tabela, ku shihet qe numri i grave dhe vajzave në studime universitare është 53.7%, pra më i madh se burrat që përbëjnë 46,3 % të studentëve në bachelor dhe master. Mirëpo në Kosovë, sa më lart që ngritemi në hierarkinë e karrierës dhe posteve të mira, aq më i vogël bëhet numri i grave.

Është interesant të përcillet se si bie numri i grave të punësuar duke u ngjitur në nivele më të larta në arsim. Gjersa në parashkollor janë të punësuar 99.7% gra dhe vetëm 0.3% burra, në nivelin fillor dhe të mesëm të ulët, numri bie në 56.1% për gratë dhe rritet në 43.9% për burrat. Në nivelin e mesëm të lartë, gratë janë të punësuar me 40.6% dhe burrat me 59.4%. Ndërsa në nivelin universitar, gratë përbëjnë vetëm 33.5% të stafit akademik, për dallim me 66.5% burra. Shihet shumë lehtë se sa më të larta dhe më të paguara vendet e punës, aq më i lartë është numri i burrave.

Mësimdhënësit sipas gjinisë dhe niveleve në arsim



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Gratë dhe burrat në Kosovë 2016-2017"

Nëse i krahasojmë burrat sipas aktivitetit të tyre ekonomik, shohim se për vitin 2017 gratë kanë pasur në pronësi 11,6% të ndërmarrjeve me 1-9 të punësuar. 88,4% e ndërmarrjeve tjera janë në pronësi të burrave. Te kategoria e ndërmarrjeve me 10-49 të punësuar, gratë përbëjnë vetëm 4,9%. Ndërsa ndërmarrjet e mëdha me mbi 50 të punësuar janë me 97% në pronësi të burrave.


Ndërmarrjet aktive sipas gjinisë së pronarëve dhe numrit të punësuarve në %

Numri i punëtorëve	1-9		10-49		50+	
	Gra	Burra	Gra	Burra	Gra	Burra
2016	11,3	88,7	4,5	95,5	3,5	96,5
2017	11,6	88,4	4,7	95,3	2,9	97,1

Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Grate dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 56.


Në vitin 2017, në Kosovë të punësuarat kanë qenë vetëm 12,7 % të grave, në krahasim me 46,6% të burrave. Ndërsa pronarë të banesës apo shtëpisë kanë qenë kryesisht burrat me 88%, shumë më lartë se gratë me 12%.

Punësimi 2017



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Grate dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 51.


Pronësia 2017



Burimi: Agjencia e Statistikave e Kosovës, "Grate dhe burrat në Kosovë 2016-2017", fq. 60.

Një raport i vitit 2015 ("Mjaft më me arsytime" faqja 46) i Rrjetit të Grave të Kosovës tregon se 40,9% të grave kanë raportuar se kanë përjetuar dhunë, në krahasim me 9,7% të burrave. I njejtë raport poashtu dëshmon në bazë të intervistave me prokurorë, gjyqtarë, dhe policë që ende mendojnë se „burrat duhet të kenë fjalën e fundit dhe që pushteti i tyre nuk duhet të minohet“ (RrGK 2015, 72).

Viktima të dhunës në familje në %



Burimi: Rrjeti i Grave të Kosovës, Mjaft me me arsytimë, 2015, fq. 46.

Këto shifra, në tërësi lënë të kuptohet se nuk është e vërtetë se gratë nuk dijnë, nuk duan apo nuk mundën. Gratë dijnë, duan dhe mundën. Por grave ju mohohet, ju pamundësohet, ju vështirësohet realizimi i të drejtave të tyre, i potencialeve të tyre, i ëndrrave të tyre. Kjo ndodhë fatkeqësisht nëpër të gjitha institucionet shoqërore, duke filluar që nga familja e vajzave, pastaj në shkollë, në punësim, në martesë, në drejtësi dhe në politikë.

DHUNA NË FAMILJE

Aktet e dhunës në familje, sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, janë: a) përdorimi i forcës fizike ose presionin psikik; b) që shkaktojnë ose kërcënojnë t'i shkaktojnë dhembje fizike dhe vuajtje psikike një tjetri anëtar të familjes; c) që shkaktojnë ndjenjë e frikës apo cenimin e dinjitetit; d) sulmin fizik; e) ofendimin, sharjen, thirrjen me emra ofendues, si dhe forma të tjera të shqetësimit të vrazhdë; f) sjelljet e përsëritura me qëllim që të përulin personin; g) aktet jokonsensuale seksuale; h) kufizimin e kundërligjshëm të lirisë së lëvizjes ndaj personit tjetër; i) dëmtimin e pronës apo kanosjen për ta dëmtuar pronën e një anëtari tjetër të familjes; j) **vënien e personit tjetër në pozitën që ai të frikësohet për gjendjen fizike, emocionale dhe ekonomike;** k) **hyrjen apo largimin me dhunë nga banesa e përbashkët apo banesën e personit tjetër;** dhe l) rrëmbimin.

Dhuna ekonomike është thelbi i të gjithë problematikës rreth dhunës në familje. Si dhunë ekonomike definohet situata kur njëra palë e shfrytëzon epërsinë e saj në qasjen ndaj mjeteve financiare në familje dhe prandaj ka një pushtet mbi palën tjetër. Dhuna ekonomike përfshin mohimin e qasjes në pasurinë e përbashkët bashkëshortore dhe

kërcënimin me largim nga prona e përbashkët. Dhuna ekonomike njihet si akt dhune edhe në bazë të Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje dhe është i dënueshëm.

Kodi Penal i Kosovës thekson se ndiqen ex-officio (sipas detyrës zyrtare) skllavëria dhe kushtet e ngjashme me skllavërinë, lëndimet e lehta trupore, lëndimet e rënda trupore, puna e detyruar dhe përdhunimi ose sulmi seksual. Edhe shkelja e urdhërave mbrojtës, sipas Ligjit për Mbrojtje nga Dhuna në Familje, ndiqet sipas detyrës zyrtare. Përpos kësaj, Kodi Penal si vepra penale i njej në nenin 251 “Shkelja e detyrimeve familjare”, përcakton në paragrafin 1: „Kushdo që shkel detyrimet e tij ligjore familjare, duke lënë në gjendje të rëndë anëtarin e familjes i cili nuk është në gjendje të kujdeset për vetën e tij, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet“.

Në Kosovë, fenomeni i **regjistrimit të pronës së familjes në emër të dikujt tjetër, me qëllim të fshehjes së pasurisë bashkëshortore, dënohet me nenin 252 „Shmangia nga sigurimi i mjeteve të jetesës“**. Aty përcaktohet se „Kushdo që i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin për të cilin është i detyruar të kujdeset në bazë të vendimit të plotfuqishëm të gjykatës, marrëveshjes së plotfuqishme gjyqësore ose vendimit të organit tjetër kompetent, me anë të shmangies së punësimit, **raportimit të rrejtshëm të punësimit apo të të ardhurave, ndërrimit të vendit të punës, ndërrimit të vendbanimit apo vendqëndrimit, tjetërsimit të pasurisë ose në ndonjë mënyrë tjetër i shmanget sigurimit të mjeteve të jetesës për personin e tillë, dënohet me burgim deri në një (1) vit.**“

Në nenin 335 „Mashtrimi“, Kodi Penal e përcakton edhe dënimin deri në 10 vjet burgim për rastet e „paraqitjes së rreme të fakteve apo duke fshehur faktet dhe me qëllim të përfitimit të kundërligjshëm të dobisë pasurore për veten apo personin tjetër, ose për t'i shkaktuar dëm material personit tjetër“.

Ligji për Familjen (LFK) Neni 47, thotë

- (1) Pasuri e përbashkët e bashkëshortëve është pasuria e fituar me punë gjatë vazhdimit të martesës, si edhe të hyrat që rrjedhin nga pasuria e tillë;
- (2) Pasuria e përbashkët mund të përfshijë gjithashtu të drejtat sendore dhe të detyrimeve;
- (3) Pasuria e bashkëshortëve e fituar bashkërisht përmes lojërave të fatit konsiderohet pasuri e përbashkët.
- (4) Bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët nëse ndryshe nuk janë marrë vesh;

Por praktika gjyqësore në Kosovë, gjatë ndarjes së pasurisë së përbashkët, është tejet diskriminuese. Është e vërtetë se ligji në nenin 54 thotë se në rast mosmarrëveshjeje rreth pjesëve të pasurisë së përbashkët, gjykata duhet të vendosë rreth atyre pjesëve në bazë të kontributit, por ligji nuk thotë se kontributi duhet të jetë monetar, por përfshin punën në shtëpi dhe familje. Për kuptimin e kësaj pjese duhen pasur parasysh dy gjëra. E para është se ligji gjatë definimit të së drejtës së barabartë në pasurinë bashkëshortore në nenin 47 nisat mbi parimin e barasvlefshmërisë së kontributit të të dy bashkëshortëve në krijimin e asaj pasurie. Vetë fakti se në nenin e njëjtë 47, në paragrafin 1, definohet se pasuri e përbashkët është pasuria e fituar me punë gjatë martesës dhe në paragrafin 4 përcaktohet se bashkëshortët janë pronarë të përbashkët në pjesë të barabarta të pasurisë së përbashkët, dëshmon kuptimin e kontributit si të barasvlefshëm brenda ligjit. Që ligji nisat nga parimi i barasvlefshmërisë së kontributit dhe punës së bashkëshortëve mbështetet edhe nga fakti, se fjala **punë** në nenin 47 nënkupton sikurse punën fitimprurëse monetare **jashtë** shtëpisë poashtu edhe punën **në** shtëpi, pra ligji nuk bën fare dallim mes këtyre dy llojeve të punës në këtë nen. Gabimi që bëhet në ligjin kosovar është se janë përdorur dy terme, termi punë dhe termi kontribut, të cilët pastaj kanë krijuar në konfuzion dhe hapësirë manipulimi.

Jo vetëm praktika ligjore, por as vetë komentari nuk e sheh të nevojshme që kontributin e gruas ta definojë sipas ligjit, i cili thotë se kontributi nuk është vetëm monetar. Mbi të gjitha, as praktika ligjore e as komentari kur flitet për pjesëtimin e pasurisë, nuk e respektojnë fare **nenin 55 (Përcaktimi i pjesëve)**, i cili e definon shprehimisht në cilën situatë ekziston e drejta e njërit nga bashkëshortët që të mos pajtohen me ndarjen e barbartë.

Neni 55, Përcaktimi i pjesëve:

- (1) *Pjesa e pasurisë së bashkëshortëve përcaktohet duke përdorur kriteret e njëjta ashtu siç janë përcaktuar në nenin 54 (1).*
- (2) ***Pjesa më e madhe e pasurisë së bashkëshortit*** në një send apo në të drejtën e caktuar, mund të përcaktohet nga gjykata **vetëm** nëse ai send ose e drejtë ekonomikisht është e pavarur në krahasim me sendet dhe të drejtat e tjera në pasurinë e përbashkët, dhe bashkëshorti për fitimin e atij sendi apo të drejte ka marrë pjesë me të hyrat nga **pasuria e tij e veçantë**.

Pasuria e përbashkët bashkëshortore dhe pasuria e veçantë janë dy institucione të ndryshme, të cilat përshkruhen brenda ligjit. Rrjedhimisht, sipas ligjit, pala e cila e

kundërshton ndarjen e barabartë të pasurisë bashkëshortore (zakonisht burrat) duhet të dëshmojë se posedon një pasuri të veçantë.

Dispozitat ligjore kanë caktuar se në rast se njëri nga bashkëshortët pretendon të ketë kontribuar më shumë në krijimin e pronës dhe pasurisë së përbashkët, atëherë ai ka të drejtë të mos pajtohet me ndarjen e barabartë të kësaj prone apo pasurie. Ligji e përcakton se bashkëshorti i cili pretendon të ketë kontribuar më shumë këtë mund ta bëjë **vetëm** nëse mund të dëshmojë se ka pasur pasuri të veçantë, të cilën e ka krijuar para lidhjes së martesës. Mirëpo praktika gjyqësore dhe gjykatat në Kosovë, gjatë trajtimit të ndarjes së pasurisë nuk i marrin mjaftueshëm parasysh dispozitat ligjore, duke kërkuar nga gratë që të dëshmojnë përmes faturave dhe transfereve se sa ka qenë kontributi i tyre material në blerjen e pronës dhe në shtimin e pasurisë së përbashkët bashkëshortore. Në këtë mënyrë, ky lloj i trajtimit të rasteve nga ana e gjykatave përpos që i shkel dispozitat ligjore të konventave ndërkombëtare, të Kushtetutës dhe të Ligjit për Familjen, të Ligjit për të Drejtat Sendore dhe Ligjit për Mbrojtjen kundër Dhunës në Familje, ky trajtim bëhet pjesë e dhunës psikologjike dhe ekonomike ndaj grave dhe shkakton vazhdimin e një padrejtësie strukturore, e cila e dëmton edhe zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të Kosovës. Ky trajtim është dhunë institucionale dhe strukturore.

RRETH ORGANIZATËS INJECT INICIATIVA PËR DREJTËSI DHE BARAZI

Në vitin 2017 është inicuar ndryshimi i Ligjit për Familjen nga Luljeta Aliu, qytetare e thjeshtë. Në mënyrë private, pa ndihmë financiare apo profesionale, edhe përkundër faktit se vetë nuk është juriste, znj. Aliu e ndërmori hapin që ta provonte mundësinë e garantuar për qytetarët me Ligjin për Iniciativa Qytetare. Luljeta Aliu ka lindur në Kosovë, por familja e saj është shpërngulur në Zvicër gjersa ajo ishte fëmijë. Ajo ka përfunduar Shkencat Politike, Letërsi Gjermane dhe Të Drejtën Ndërkombëtare në Universitet të Cyrihut. Pas përfundimit të magistraturës në Politikë të Sigurisë Ndërkombëtare në vitin 2008, ajo është kthyer të jetojë në Kosovë.

Në vitin 2017, pasi kishte kaluar vetë nëpër procese gjyqësore për dhunë në familje, Luljeta Aliu e ka bërë një analizë të dispozitave ligjore në lidhje me pasurinë e përbashkët dhe mbajtjen financiare bashkëshortore dhe e ka inicuar një ndryshim të Ligjit për Familjen. Komisioni për Legjislacion e ka pranuar kërkesën dhe projektligji është votuar në lexim të parë në Kuvend nga të gjithë deputetët e pranishëm me datën 13 korrik 2018. Iniciativa e propozuar nga Luljeta Aliu për ndryshimin e Ligjit për Familjen është miratuar në shqyrtim të dytë me 21.12.2018 dhe ka hyrë në fuqi me shpalljen në Gazetën Zyrtare me datën 17.01.2019.

Luljeta Aliu e themeloi më vonë organizatën INJECT Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi, misioni i së cilës është që përmes intervenimit në kornizë ligjore dhe praktikë gjyqësore të sigurohet mbrojtja e të drejtave dhe e pronës së të gjithë qytetarëve, për t'i fuqizuar të gjithë në mënyrë të barabartë. Vizioni i INJECT është që Kosova të bëhet vërtetë një shtet, i cili të gjithë qytetarëve të vet ju ofron siguri sociale, të drejta të barabarta dhe shanse të barabarta, pa dallim gjinie, religjioni, etnie apo orientimi seksual.

A stylized graphic in shades of purple and magenta, depicting a person with their arms raised in a gesture of celebration or triumph. The figure is composed of simple, rounded shapes, including a circular head and thick, curved limbs. The background is a solid dark purple, and the graphic is positioned in the lower right quadrant of the page.

www.inject-ks.org

FB: INJECT Iniciativa për Drejtësi dhe Barazi

INSTA: injectorg